

Raif Morina

SAMI FRASHËRI DHE DRAMA E TIJ "SEJDI JAHJA"

Pa mëdyshje që Sami Frashëri është njëri nga dijetarët më të mëdhenj të kohës së vet, andaj mua personalisht më pëlqen të them se Samiu, me punën dhe veprën e tij kaq madhore në shkencë e letërsi dhe në përgjithësi, ishte agu dhe shkëlqimi i diturisë së fillim shekullit XX. Edhe pse, fatkeqësisht, ai jetoi relativisht pak, gjithsejtë 54 vjet (1850 – 1904), ai, megjithatë, për ato vite të jetës së tij, arriti ta ngrisë aq lart edukimin dhe emancipimin e tij personal dhe të shkruajë aq shumë vepra saqë edhe sot, plot njëqind vjet pas vdekjes së tij, mendja jonë nuk mund ta sqarojë sesi ai mundi t'i arrijë të gjitha ato. Sami Frashëri i njihte në nivel letrar gjathtë gjuhë botërore, përveç gjuhës amtare shqipe: Arabishten, turqishten, persishten, frëngjishten, greqishten dhe italishten. Në shumicën prej këtyre gjuhëve shkroi vepra të ndryshme letrare dhe shkencore me famë botërore si dhe përktheu disa vepra nga njëra gjuhë në tjetrën. Vepra e tij e shkruar është aq voluminoze saqë mendoj se edhe sot ia kanë lakmi shumë institute dhe akademi kombëtare në shumë vende të botës. Vetëm sa për kuriozitet do të kisha theksuar se Samiu për vetëm 32 vjet krijimtari shkroi rreth 60 libra ose, thënë pak më detajisht: ai shkroi dhe botoi më se 20.000 faqe shkrim të formateve 17 x 25 dhe 30 x 20 cm. pa i llogaritur këtu fare veprat të cilat i kanë mbetur në dorëshkrim. Andaj, po të llogaritnim edhe ato, na del se Samiu për çdo vit të krijimtarisë së tij mesatarisht shkroi rreth 1.000 faqe tekst në formë të librave, dhe tani këtu përsëri nuk i janë llogaritur shkrimet e tij të shumta nëpër gazeta, shumicën prej të cilave ai i redaktoi, i udhëhoqi dhe i botoi personalisht. Andaj, mu për këtë, me plot të drejtë mund të themi se Sami Frashëri ishte një erudit. Përveç kësaj, kur këtij vëllimi kaq të madh të veprave të tij, ia shtojmë edhe faktin tani të dëshmuar dhe të njohur se ai, për shembull, është pionier i letërsive të ndryshme kombëtare nga njëra anë, dhe në anën tjetër se shumë vepra të tij leksikografike dhe enciklopedike janë të pazëvendësueshme edhe në ditën e sotme na mbetet të themi se Samiu ishte një gjeni. Vetëm sa për ilustrim të ju përkujtojmë se romani i Samiut "*Dashuria e*

Talatit dhe Fitnetes” llogaritet si romani i parë, jo vetëm i Gjuhës dhe Letërsisë Turke, por edhe i asaj Shqipe, si edhe drama “Besa” në lëmin e dramaturgjisë. Ndërsa Fjalori i tij i gjuhës turke, edhe sot e kësaj dite pothuajse është i pazëvendësueshëm përkundër shumë fjalorëve të tjerë të botuar edhe tash së voni nga institute të ndryshme kombëtare të Turqisë.

Epitete, si më lart, për Samiun jo që dëshirojmë të themi ne sot, por këto dhe shumë të tjera ia pranuan dhe publikisht i thanë edhe bashkëkohësit e tij, andaj me këtë rast ne po i cekim vetëm dy nga ato: I pari ishte se Samiun është punëtori më i madh i Perandorisë Osmane, ndërsa epiteti i dytë ishte se Sami Frashëri ishte personi numër një i Perandorisë që pranonte më së shumti letra nga e gjithë bota. Andaj këto epitete dhe fakti i fundit, na japin të kuptojmë se Sami Frashëri ishte një kozmopolit i vërtetë, pra ishte qytetar i tërë qytetërimit të atëhershëm...

Samiu u lind në Frashër, jetoj në Stamboll, por pa mëdyshje se i takoi edhe Lindjes edhe Perëndimit. I takoi jo rastësisht, por me punën dhe angazhimin e tij. Ai jetoj në Lindje, por gjithmonë insistoi dhe punoi që edhe Perëndimi të jetë i pranishëm në Lindje dhe anasjelltas, andaj edhe përktheu nga frëngjishtja në turqishte “*Robinson Kruzon*” e Daniel Defosë, “*Të Mjerët*” e Viktor Hygos, “*Tre Musketarët*” e Aleksandër Dumasë, dhe mu për këto qëllime hartoi edhe fjalorët voluminozë “*Frëngjisht – turqisht*” me më se 50.000 fjalë dhe “*Turqisht frëngjisht*” me më se 35.000 fjalë. Pra Sami Frashëri ishte iluminist, ishte njeri që ndikoi në përhapjen e diturisë, shkencës e të kulturës në suaza ndërkombëtare. Ishte njeri i progresit e jo i regresit, njeri i arsyes e jo i dokeve. Hidhërimi i tij ishte çdoherë i madh kur ai me të shoqen dhe fëmijët e tij në Stamboll dilte në qytet për të shëtitur, e sipas zakoneve të atëhershme duhej që në karroca të hypnin veç femrat e veç meshkujt.

Njëherit, nuk do koment çështja se Sami Frashëri ishte ideologu kryesor i Rilindjes Kombëtare Shqiptare për pavarësi, shkollim dhe arsimim, edukim dhe progres të popullit shqiptar. Në këtë shkrim timin lidhur me largpamësinë, strategjinë dhe gjenialitetin e Samiut për çështjet dhe problemet e kohës, e gjithë kjo në kuadër të Iluminizmit si Lëvizje kulturore dhe politike e shek XVIII dhe XIX, e të cilat mendime u dëshmuar si plotësisht të sakta, do të përmendja një historian Anglez i cili tani vonë, hiq më shumë se para 6 vjetësh, në librin e tij “*KOSOVA - një histori e shkurtër*” konstaton atë që Samiu e thoshte dhe insistonte që të bëhej e të ndodhte para se të bëhej e të ndodhte ashtu siç ndodhi. Historiani Noel Malcolm në librin e tij të sipërshtënuar, në faqen 260 të botimit shqip më 1998, e që ka të bëjë me përgjegjësinë e rënies së Perandorisë Osmane, thotë se përgjegjësinë afatgjatë:” *e kanë ata politikanë osmanë, të cilët me aq kokëfortësi*

kundërshtuan kërkesat e shqiptarëve gjatë 34 vjetëve të kaluara... Pra, gabimi ishte i tyre. Sikur t'u jepej lirshëm autonomia shqiptarëve... ata do të krijonin një bastion të fortë kundër copëtimeve të mëtejme të Perandorisë..."

Mirëpo, fatkeqësisht Sulltani nuk e kuptoi dot ose e kuptoi mbrapsht idenë dhe kontributin e Samiut si njeri i dijes dhe i penës. Andaj edhe veproi ashtu si veproi dhe më vonë ndodhi ajo që ndodhi, por përkaj gjithë të tjerave, së paku nuk u dasht që Sulltani ta bënte atë që ia bëri një njeriu kaq të madh, një njeriu kaq punëtor e të vyeshëm, një njeriu që kaq shumë i kontribuoi jo vetëm Perandorisë Osmane, por edhe gjithë qytetërimit, siç ishte Sami Frashëri; Sulltan Abdylhamiti e dënoi Sami Frashërin me burg shtëpiak!

Andaj, në mes tjerash, jam i mendimit se mu nga këto qëndrime iluministe të Sami Frashërit mund të dalë edhe konkludimi për atë se çka e shtyri Samiun që për temë të dramës së tij të dytë me radhë (pas "Besës") – ta merrte një ngjarje kaq të hijdhur të ndodhur në Andaluzi të Spanjës në fund të shek.XV dhe në fillim të shekullit XVI. Ndjenjat dhe idetë humaniste të Sami Frashërit, nuk e lan të qetë këtë njeri pa e dënuar Kryqëzatën dhe Inkuizicionin spanjoll, përveç tjerash edhe me një vepër dramaturgjike, siç është drama "*Sejdi Jahja*". Ai me siguri pati dëshirë që ato mizori të ndodhura në Andaluzinë e Spanjës së asaj kohe, ku njerëzit izoloheshin me muaj të tërë për të vdekur nga uria, vriteshin e persekutoheshin vetëm e vetëm pse ishin myslimanë, ta pasqyrojë edhe përmes madhështisë së dramës dhe të skenës, duke ua mundësuar qytetarëve për të lexuar e për të parë sesa të tmerrshme janë verbëria dhe prapambeturia e absolutizmit monarkist. Andaj, edhe pse përmbytja e kësaj drame është e trilluar, ashtu siç e thotë edhe vetë Samiu në parathënien e dramës "*Sejdi Jahja*", pasi që ngjarje të tilla kanë ndodhur në historinë e Spanjës së asaj periudhe, si personazhe të dramës janë edhe mbreti Ferdinand si dhe mbretëresha Izabela, nën udhëheqjen e të cilëve, sa në mënyrë tragjike, po aq edhe të turpshme, bëhej pastrimi dhe zhdukja e më se tre milionë myslimanëve nga Andaluzia.

Motivi i arësyes "*Sejdi Jahja*" është marrë nga historia islame. Vendi: Andaluzia e Spanjës – "*Rajon autonom në jug të Spanjës, me 8 provinca, midis të cilave me kryesoret janë: Almeria, Kadiks, Grenada, Malaga, Sevilja etj, me një sipërfaqe prej 87.268 km² dhe me një popullatë prej 6.963.000 banorëve*"¹ Koha: Fundi i shek. XV dhe fillimi i atij XVI, pra është koha kur mbretëritë e shumta arabe në Spanjë, pas sundimit disashekullor të Perandorisë Arabe, po

¹ * Shih FIALORIN ENCIKLOPEDIK hartuar dhe përgatitur nga PASHO BAKU¹, shtëpia botuese Bacchus Tiranë, 2002 (përkthyesi)

shpartalloheshin dhe binin njëra pas tjetrës në duart e Spanjollëve. Përbajtja e dramës është si vijon:

Spanjollët e rrethojnë kalanë e Razesë e cila ndodhet nën komandën e Sejdi Jahjasë. birit të mixhës së halifit të Andaluzisë, Mulla Ebu Hasanit. Meqë rrethimi i kalasë zgjat një kohë të gjatë, mbrojtësit e kalasë, së bashku me popullatën, mbesin pa ushqime për shkak të pamundësisë së furnizimit, andaj edhe janë duke vdekur më shumë nga uria sesa nga dyluftimet. Brendia e kalasë është mbushur me varre. Një ditë Sejdi Jahja, tek ka dalur për t'i bërë një vizitë kalasë, i dëgjon mallkimet e një plaku ndaj tij, se përse ky nuk e dorëzon kalanë. Ndërsa një grua është ulur mbi një varr dhe vajton të birin e fundit nga të katër djemtë të cilët i kishin vdekur njëri pas tjetrit. Diku, pak më larg, shfaqet fantazma e cila i thotë se çdo qëndresë e tij është e kotë, meqë përditë i vdesin me mija njerëz, andaj patjetër i duhet që ta dorëzojë kalanë.

Mirëpo, pak më vonë e takon shërbëtorin e vet me emrin Osman, i cili i jep kurajë që ta vazhdojë mbrojtjen. Përndryshe, Sejdi Jahja këtij shërbëtori të tij ia ka dhënë në përkujdesje edhe çupën e vet dyvjeçare, Halimen. Kështu, Sejdi Jahja, duke bërë dert me Osmanin, i afrohet një tregtar i quajtur Ibrahim dhe i sugjeron Sejdi Jahjasë që ky ta dorëzojë kalanë meqenëse spanjollët atij i paskan dhënë garancione se, nëse kalaja dorëzohet në mënyrë vullnetare, askujt nuk ka për t'i ndodhur asnjë e keqe. Mirëpo, Sejdi Jahja e dikton se ky farë Ibrahim është bashkëpunëtor i armikut dhe natyrisht që nuk pajtohet që ta bëjë dorëzimin e kalasë. Të vdekur se të vdekur, o nga uria, o nga shpata e armikut. Sejdi Jahja së bashku me mbrojtësit e kalasë merren vesh që bile në fund të fundit të ndërmarrin një sulm ndaj armikut që të provojnë thyerjen e rrethimit. Mirëpo, këtë nuk mund ta bëjnë për shkak se një natë më parë, pasi ishte në roje, Sejdi Jahjanë e tradhton një njeri i tij i quajtur Zejd, të cilit spanjollët i kishin premtuar njëzet mijë talira nëse ky e kryen me sukses tradhtinë. Dhe ashtu edhe ndodh. Zejdi ua dorëzon Sejdi Jahjanë spanjollëve në gjumë. Mirëpo, spanjollët edhe pse e burgosin Sejdi Jahjanë, kalaja vazhdon të qëndrojë e pa mposhtur edhe më tutje. Njëri nga të burgosurit spanjoll të po asaj qelie ku ishte prangosur edhe Sejdi Jahja, i quajtur me emrin Pedro, pasi që e bind gardianin dhe tek e mashtroi edhe Sejdi Jahjanë që këtij t'ia jepte rrobat e veta, del nga burgu. Sejdi Jahja gabimisht dhe në hutë, përveç rrobave, atij ia ka dhënë edhe vulën e vet. Tani Pedroja, pasi është veshur me rrobat e Sejdi Jahjasë, paraqitet se është ai vetë (Sejdi Jahja), edhe i çon fjalë mbretit të Spanjës, Ferdinandit, se dëshiron të bisedojë me të. Mbreti pajtohet që ta pranojë në bisedë këtë tradhtar të quajtur Pedro, duke menduar se është duke e pranuar Sejdi Jahjanë. Andaj, gjatë asaj bisede mbreti merret vesh me Pedron për

dorëzimin e kalasë dhe se në emër të shpërblimit për këtë shërbim, Pedroja nga ana e mbretit emërohet komandant i kalasë. Pas kësaj, shërbëtori i Sejdi Jahjasë – Osmani, i biri i tij Jusufi dhe e bija e Sejdi Jahjasë, Halimja, zihen robër nga spanjollët dhe torturohen nga njëfarë personi i quajtur Françesko.

Kështu kalojnë më se gjashtëmbëdhjetë vjet; Sejdi Jahja është në burg, ndërsa këta robër të Françeskos. Halimja rritet duke menduar se është e bija e Osmanit dhe e motra e Jusufit. Një ditë, Osmani ia zbulon sekretin të birit, Jusufit, se Halimja nuk është motra e tij, sepse ajo është e bija e Sejdi Jahjasë. Andaj, nga ai moment ndjenjat e dashurisë së Jusufit ndaj Halimes si ndaj motrës që i kishte, ndryshojnë. Ajo kalon në tjetër dashuri. Duke mos mundur të durojë më gjatë, Jusufi tërë ngjarjen ia rrëfen Halimes. Në ndërkohë, Sejdi Jahja duke përfutur nga një amnesti e përgjithshme që e kishte aprovuar mbreti, pasi del nga burgu shkon te mbreti dhe ia zbulon atij sekretin, duke ia bërë me dije se ky është Sejdi Jahja i vërtetë e jo Pedroja i cili është një hajn dhe që e kishte mashtruar atë në burg duke ia marrë rrobat. Mbreti i Spanjës, Ferdinandoja me të marrë vesh këto marifetHëqe të Pedros, urdhëron që atij menjëherë t'ia vënë prangat dhe ta fusin në burg. Ndërsa Sejdi Jahjasë, pasi ia jep shpatën, e pyet se çka kërkon prej tij. Drama përfundon me këtë dialogë:

FERDINANDOJA: (*Jahjasë*) Ti, o plak i ndershëm e atdhetar! Kërko çka të kërkojsh prej meje!... Jua jap fjalën e nderit se do t'jua plotësoj dëshirën!

JAHHAI: Vetëm rrugën ta kemi të hapur dhe të shkojmë kah të duam ne! Vetëm për këtë kërkojmë ndihmën tuaj!

FERDINANDOJA: Nëse doni, mund t'i shkruaj mbretit të Marokut që vajzën tënde ta marrë për djalin e tij!

JAHHAI: (*Duke ia rrahur shpinën Jusufit*) Jo, nuk dua! Sepse vajzën e kam të fejuar!

FERDINANDOJA: (*Shoqëruesve*) Atëherë, u thoni atyre që për këta burra të përgatisin disa përcjellës dhe ata të sigurojnë shkuarjen e këtyre kah të duan dhe ku të duan. Ndërsa këtë tradhtar, e futni në burg menjëherë!

TË GJITHË: Rroftë drejtësia! (*Shoqëruesit e marrin Pedron dhe e dërgojnë në burg*).

JAHHAI: (*Pasi i përqafton fëmijët*) Fëmijët e mi, ejani se ia arritëm qëllimit dhe na u plotësuan dëshirat.

OSMANI: Vetëm në saje të drejtësisë!

Rroftë drejtësia!

Si përkthyes i kësaj drame të cilën e kam parë të arsyeshme ta botoj me rastin e përkujtimit të njëqindvjetorit të vdekjes së autorit. Këtë parathënie timen e shoh të udhës që ta përfundojë ashtu si pati thënë edhe vetë Samiu;” *Meqë “BESA” ime u mirëprit nga të gjithë, më jep kurajë për botimin edhe të kësaj drame dhe shpresoj se do të mirëpritet gjithashtu”.*